



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 08
Prishtinë, më 03.04.2012, në orën 11.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Kurtan Kajtazi, Biserka Kostiq, Kymete Bajraktari dhe Kimete Bytyçi.

Munguan: Justina Pula, Rita Hajzeraj, Albana Gashi dhe Duda Balje.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinators dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Te ftuar: Basri Berisha-zëvendësavokat i popullit.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi-OSBE, Visar Bivolaku- EU OFFICE, Elita Vokshi-OSBE, Florije Mehmeti-KDI, Zanë Hoxha- zyra e sekretarit, Nehat Dervishi-OSBE, Blerta Aliu- Koha ditore, Leonora Dalipi- RTV 21, Nuredin Ibishi- CDF dhe Burim Tahiri- praktikant.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takim me Avokatin e Popullit, përfaqësuesin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, dhe i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale të cilët e

informojnë Komisionin rreth veprimeve të marra në drejtim të përmbushjes së pikave 18, 20 dhe 53 të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012;

3. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Takim me Avokatin e Popullit, përfaqësuesin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, dhe i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, të cilët e informojnë Komisionin rreth veprimeve të marra në drejtim të përmbushjes së pikave: 18, 20 dhe 53 të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012

Kryetarja, pasi iu dëshiroj mirëseardhje, theksoi se komisionet parlamentare janë të obliguara t'i përmbushin detyrat që dalin nga Plani i Veprimit dhe nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian.

Ajo shtoi se sot e kemi ftuar institucionin e Avokatit të Popullit, dhe do të dëgjojmë lidhur me përmbushjen e pikave 18 dhe 20, ku thuhet se institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës mbetet i dobët, për shkak të mungesës së mbështetjes politike në sigurimin e pavarësisë së mirëfilltë funksionale dhe financiare. Rekomandimet e Ombudspersonit kërkojnë mbështetje nga Zyra e Kryeministrit për të siguruar zbatimin e tyre. Rekrutimi i zëvendësve të Ombudspersonit ende nuk është përfunduar. Tani rekrutimi i zëvendësve të Ombudspersonit është kryer, po në raport janë, sepse është bërë për vitin 2011, e në ndërkohë kryhen.

Komisioni i ka pasur disa kërkesa dhe ankesa, sidomos për hapësira, për mungesa financiare rreth imunitetit të Avokatit të Popullit etj.

Ne e kemi parë të arsyeshme të kemi prezent përfaqësuesin e Avokatit të Popullit, i cili do të na informoj me hollësisht.

Basri Berisha, Institucioni i Avokatit të Popullit- Tha se ne, si komision, ishim edhe në dëgjim publik, sa i përket monitorimit të ligjit të Avokatit të Popullit, ku u cekën se ishin disa probleme sa i përket imunitetit, pavarësia financiare. Problem tjetër ishte edhe selia e zyrës qendrore të Ombudspersonit, por edhe te ato rajonale, kemi pasur probleme të caktuara në komunat e Gjilanit dhe të Mitrovicës. Problemet në këto dy komuna kanë qenë sa u përket zyrave, ishte edhe një odesiadë sa u përket pagave, por kjo diçka ka nisur tani të realizohet. Megjithatë jo deri në atë masë sa meritohet,

Kimete Bytyqi- Tha se desha të ndërlihem sa i përket pikës 18, Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar kërkesën tuaj lidhur me kërkesën financiare. Unë desha të pyes a është Qeveria e njoftuar me pozitën tuaj të vështirë dhe pse nuk u jep mbështetje zyra e Kryeministrit për zbatimin e rekomandimeve, si dhe në pavarësimin e ushtrimit të detyrave tuaja?

Kurtan Kajtazi- Tha se sa i përket institucionit të Avokatit të Popullit, ne jemi në vazhdimësi në rrjedha me punët dhe me vështiruesit e këtij institucioni, për të funksionuar mirë ky institucion, normalisht se duhen financa, edhe selia, por edhe institucioni i Avokatit të Popullit duhet t'i adresoj kërkesat në vendin e duhur dhe në kohën e duhur.

Basri Berisha- Tha se informimi është i një rëndësie të veçantë për çdo institucion, ashtu edhe për institucionin e Avokatit të Popullit, mund të themi se prej qershorit të vitit 2011 është përmirësuar situata sa i përket komunikimit. Tani kemi edhe udhëheqës të zyrës për media, kemi një paraqitje tabelore, ku ju do të mund ta shihni punën dhe komunikatat për media të zyrës për komunikim.

Për paraqitjen mediale të vetë Avokatit të Popullit nuk kemi statistika. Është bërë edhe një ridizajnim i ueb -faqes së institucionit të Avokatit të Popullit.

Biserka Kostiq- Unë do të lidhem me pikën 20 të Planit të Veprimit, pasi e përmendet ueb-faqen, dihet se gjuha serbe është gjuhë e dytë zyrtare në Kosovë. Më intereson të dijë sa respektohen gjuhët e komuniteteve të tjera në këtë ueb-faqe dhe në ueb-faqe materiali duhet të jetë edhe në gjuhën serbe, në mënyrë që ky komunitet të jetë i njoftuar me punën e këtij institucioni.

Ajo gjithashtu bëri pyetje se a keni të punësuar nga minoritetet, sa respektohet kodi i multietnicitetit rreth punësimit sa i përket këtij institucioni.

Kymete Bajraktari- Tha se sa u përket ditëve të hapura kjo është një praktikë shumë e mirë, por sa praktikohet kjo nëpër komuna, a ka përmirësime? Sa i përket vitit të kaluar, ditët e hapura janë mbajtur vetëm sa për të qenë në Prishtinë, ndërsa nëpër komuna unë e di që ditët e dyerve të hapura janë mbajtur më 26 janar dhe më prej asaj dite nuk ka asnjë komunikim të qytetarëve të Komunës së Suharekës me institucionin e Avokatit të Popullit.

Basri Berisha- Tha se i kemi zyrat rajonale. Zyra rajonale në Prizren përfshin edhe Komunën e Suharekës dhe qytetarët nuk duhet të presin vetëm ditën e dyerve të hapura, por e kanë zyrën rajonale të hapur çdo herë dhe duhet të shkojnë dhe të interesohen lidhur me ankesat e tyre. Ekzistojnë mënyrat e ndryshme të paraqitjes së ankesës.

Sa u përket ditëve të dyerve të hapura secili nga zëvendësit e avokatit e ka një rajon të caktuar dhe zakonisht shkon njëherë në muaj, ku do të mbahet me dyer të hapura. Në janar është mbajtur takimi ditët me dyer të hapura, ndërsa në muajin shkurt dihet se kanë qenë pengesat për shkak të borës, tani kemi publikuar takimet ditët e hapura që do të mbahen në muajin prill, sepse i kemi datat e caktuara për tre muaj, por i kemi publikuar vetëm për prill, në atë mënyrë që mos po duhet të ndryshohet diçka për takimet në muajt e tjerë. Kështu që ka mbetur për çdo muaj agenda të publikohet në ueb- faqe, të cilës do t'i përmbahemi në mënyrë strikte. Mirëpo ato komuna që kanë zyrat rajonale e kanë punën më të lehtë, sepse të mos e presin vetëm takimin me ditët e hapura, por kanë mundësi që problemet dhe ankesat e veta t'i paraqesin në zyrat rajonale të institucionit të Avokatit të Popullit.

Kymete Bajraktari- Tha se sa janë të njoftuar qytetarët për takimin me ditët e hapura. Mirëpo këto takime duhet të sensibilizohen, sepse janë shumë të mira, praktikë shumë e mirë dhe është çështje shumë e rëndësishme për komunikim me publikun.

Basri Berisha- Tha se vitin e kaluar ka qenë më problem, sepse ka qenë vetëm Avokati i Popullit. Tani janë edhe pesë zëvendësit e tij dhe secili ka nga një rajon të caktuar dhe tani është një punë më e lehtë. Ne i informojmë zyrat rajonale dhe i qesin njoftimet nëpër komuna për ditët me dyer të hapura, por ka disa komuna që kanë bashkëpunim me disa radio lokale dhe bëhet njoftimi se kur mbahet ky takim, sepse bëhet fjalë për interesin e përgjithshëm të qytetarëve.

Kryetarja- E falënderoj zëvendësavokatin e Popullit, Basri Berishen, që ju ka përgjigjur ftesës dhe pyetjeve nga të pranishmit.

3. Te ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pat diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali